



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

Nr. 8391 Prot.

Tiranë, më 29.12. 2025

URDHËR

Nr. 623, datë 29.12. 2025

PËR

**SHPALLJEN E KONKURSTIT TË TEKSTEVE TË REJA SHKOLLORE PËR
KLASËN E PARË, KLASËN E GJASHTË DHE KLASËN E DHJETË PËR VITIN
SHKOLLOR 2026-2027**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenit 47 të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pikës 11 të kreut I të udhëzimit nr. 26, datë 17.11.2025 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të konkurrimit, vlerësimit, përzgjedhjes dhe përditësimit të teksteve shkollore dhe përmbajtjeve digjitale si dhe miratimit të katalogut zyrtar të teksteve shkollore në sistemin arsimor parauniversitar”, vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 514, datë 25.09.2025 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit” dhe të urdhrit nr. 578, datë 11.11.2025 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit, znj. Orjana Osmani”,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e konkursit për tekste të reja shkollore për klasën e parë, klasën e gjashtë dhe klasën e dhjetë për vitin shkollor 2026-2027 për lëndët si më poshtë:
 - a) Qytetaria 1;
 - b) Qytetaria 6;
 - c) Qytetaria 10;
 - d) Gjuha shqipe 10.
2. Datat e aktiviteteve për konkursin e teksteve shkollore të reja për klasën e parë, të gjashtë dhe të dhjetë janë:

a) Shpallja e konkursit	29 dhjetor 2025
b) Dorëzim i teksteve për vlerësim	31 mars 2026
c) Shpallja e rezultateve të konkursit	27 prill 2026
d) Shpallja e fituesve	14 maj 2026

3. Hartimi i teksteve shkollore të reja të bëhet në përputhje me programet mësimore të lëndëve të mësipërme dhe të standardeve të teksteve shkollore, të rishikuara, sipas legjislacionit në fuqi.
4. Për secilin prej titujve të përfshirë në këtë urdhër, çdo botues ka të drejtë të konkurrojë vetëm me një alternativë për lëndë/klasë.
5. Shtëpitë botuese që do të konkurrojnë për tekstin e lëndës “Qytetaria 1”, nuk do të përgatisin kreun me tematikë “Familjet tona” dhe për tekstin e lëndës “Qytetaria 6”, nuk do të përgatisin kreun me tematikë “Tregu global”. Autor për këto tematika do të jetë “Junior Achievement”.
6. Teksti shkollor që paraqitet për konkurs, të përputhet me kriteret e përcaktuara në udhëzimin përkatës dhe standardet e teksteve shkollore të rishikuara.
7. Për pajisjen me tekste të nxënësve të pakicave kombëtare, botuesit që do të konkurrojnë për titujt e mësipërm, të sigurojnë paraprakisht edhe të drejtën për përkthimin në gjuhët e pakicave kombëtare.
8. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Komisioni i Vlerësimit të Teksteve Shkollore në Ministrinë e Arsimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI

